



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.384/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.02.2025, merr këtë:

#### V E N D I M

- I. Pranohet e bazuar ankesa e Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), Anr.384/2025 e datës 05.02.2025,
- II. Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të pjesëmarrjes së fëmijëve në fushatë zgjedhore, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 2,000.00( dymijë) euro.
- III. Detyrohet Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), që gjobën e shqiptuar si në pikën -I, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

#### A r s y e t i m

Me datën 05.02.2025 PZAP-i, ka pranuar Ankesën Anr.384/2025, nga Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendohet se më datë 4 shkurt 2025 në orën 17:00, subjekti politik Partia Demokratike e Kosoves mbajti një tubim elektoral në qytetin e Gjilanit, përkatësisht në sheshin Nuhi Berisha dhe Rexhep Shala që gjendet në

qendër të qytetit. Më tutje parashtruesi i ankesës ka theksuar se gjatë mbajtjes së këtij tubimi, monitoruesit e organizatës sonë kanë vërejtur dhe raportuar pjesëmarrje të fëmijëve nën moshën 15 vjeçare në këtë aktivitet politik, për më tepër, kjo prezencë e fëmijëve në këtë tubim politik vërehet qartë edhe nga një video e këtij tubimi që është publikuar në rrjetin social në Facebook të kandidatit për kryeministër nga kjo parti z.Bedri Hamza. Po ashtu, edhe nga fotografitë e këtij tubimi të paraqitur në rrjetin social facebook të kandidatit për deputet e kryeministër z.Bedri Hamza vërehen gjithashtu prezencë e fëmijëve nën moshën 15 vjeçare që ishin të pranishëm në këtë tubim. Prandaj, sipas parashtruesit të ankesës veprimet e tilla të ndodhura gjatë këtij eventit politik, bien ndesh me dispozitat e Rregullores nr.07/2024 për fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

Parashtruesi i ankesës si provë, ka bashkangjitur linkun e videos në facebook (nga sekonda 10 deri në sekondën e 14) si dhe nga minuta (16:28 deri në 16:30 sek) të postuar nga kandidati për deputet Bedri Hamza ku shfaqen pamjet e fëmijëve nën moshën 15 vjeç: <https://www.facebook.com/bedrihamza.official/videos/1262253778197087> dhe fotografinë <https://www.facebook.com/photo.php?fbid=999612122055952&set=a.311352140881957&type=3>.

Më datë 06.02.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më datë 06.02.2025, deri në ora 19:00.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka theksuar se e kundërshton në tërësi ankesën për faktin se PDK njofton PZAP-in se me rastin e pranimit të ankesës nuk ka pranuar ndonjë fotografi apo videoincizim të bashkëngjitur në ankesë, prandaj PDK ka tentuar që përmes linçeve të theksuara në ankesë të qaset në fotografinë dhe videoincizimin e paraqitur në ankesë. Mirëpo, me rastin e hapjes së linçeve, linku i bashkëngjitur për video është i pa qasshëm, ndërsa hapet vetëm linku i fotografisë nga tubimi. Andaj PDK, për këtë ankesë parashtron përgjigje vetëm sa i përket pamjeve që shihen në fotografinë e publikuar nga z. Bedri Hamza me rastin e mbajtjes së tubimit në Komunën e Gjilanit, për shkak se videoincizimi është i pa qasshëm dhe me rastin e pranimit të ankesës, nuk kemi pranuar ndonjë CD për shikimin e videoincizimit të theksuar në ankesë. Ë përgjigje në ankesë është theksuar Më tutje në përgjigje në ankesë theksohet se në lidhje me fotografinë e tubimit në Komunën e Gjilanit, ashtu siç mund të vërehet në këtë fotografi, fëmija i mitur i cili shihet në fotografi, është në prehrin e nënës së tij, andaj si i tillë konsiderohet se fëmija ka pëlqimin dhe është nën prezencën e prindit të tij, andaj si i tillë edhe nuk paraqet ndonjë shkelje të rregullave zgjedhore të pretenduar me ankesë.

Si provë në përgjigje në ankesë ka bashkangjitur një fotografi.

PZAP, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

## **Ankesa është e bazuar**

Paneli ka gjetur se nga video e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se subjekti politik PDK, përkatësisht gjatë fushatës zgjedhore në tubimin e tyre ka përfshirë edhe fëmijë, veprime këto në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenin 5, par. 3 të Rregullores Zgjedhore nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, me të cilën përcaktohet se "*Asnjë subjekt politik i certifikuar nuk mund të angazhojë persona nën moshën pesëmbëdhjetë (15) vjeç në fushatë zgjedhore*".

Paneli, me rastin e vendosjes i shqyrtoi pretendimet e subjektit politik PDK, të theksuara në përgjigje në ankesë, por për Panelin këto pretendime ishin të pabazuara nga se nga video e ofruara si dëshmi nga Instituti Demokratik i Kosovës KDI, shihet se në tubimin elektorale të mbajtur në qytetin e Gjilanit shihet qartë pjesëmarrja e fëmijës nën moshën 15 vjeç, gjatë fushatës zgjedhore për përfitime të votave për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, dhe nuk janë në përcjelljen e prindërve.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislationit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislationit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik PDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës.

Kështu që duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se "*vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të bazuara, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e pranoi të bazuar.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim nenit 118 paragrafi 1, dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr.384/2025 datë 07.02.2025

Kryesues i Panelit  
Skender Çoçaj



*Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.*